



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12,14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 10 paragrafi 1 pika 1.5 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës e datës 22 nëntor 2012, nenit 20 paragrafi 11 të Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, dhe nenit 9,17,20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008, në mbledhjen e mbajtur me 18. 12. 2015, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës, miratoi këtë :

VENDIM

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË TOKËS-PASURI SHOQËRORE PËR VENDOSJEN E TRAFOSTACIONIT DISTRIBUTIV NË FSHATIN KROJMI

Neni 1

Me këtë Vendim ipet në shfrytëzim për periudhën afatgjatë prej 99 vite toka-Pasuri Shoqërore KEDS-it sh.a Divizioni i shpërndarjes Prishtinë për vendosjen e TS-it me fuqi 160kVA të tipit Shtyllë-metalike me sipërfaqe prej 10m² në pjesën e ngastrës kadastrale:

P-71409039-00519-0 në vendin e quajtur "Pojate Xhira" me kulturë kullosë e kl.2-të me sipërfaqe prej 1135m² e evidentuar në Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme Nr.4648/15 ZK Krojmir, P.Sh. Kuvendi Komunal Lipjan.

Neni 2

Prona e përshkruar në nenin 1 të këtij Vendimi, respektivisht sipërfaqja prej 10m² e nevojshme për vendosjen e TS-it me fuqi 160kVA i ipet në shfrytëzim për periudhën prej 99 viteve KEDS-it sh.a Divizioni i shpërndarjes Prishtinë, me qëllim të përmirësimit të rrjetit elektrik dhe furnizimit më të mirë me energji elektrike në fshatin Krojmir.

Neni 3

Obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër pas marrjes së këtij Vendimi në bashkëpunim me Drejtoratin për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, ta bënë parcelazimin e sipërfaqës e cila ipet në shfrytëzim dhe e njëjta të regjistrohet në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim për periudhën afatgjatë për 99 vite Kompanisë KEDS.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit-Spektori pronëso-ro-juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtorati për Urbanizëm Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

15Nr. 464-61545

Lipjan, më 21. 12. 2015

KUVENDI I KOMUNËS SË LIPJANIT

KRYESUESJA E KUVENDIT
Vlora Limani-Hajnuni

